



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236391

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453172

**AC-I-23-0208**

**Në ankesën e**

**Paditësi**

**Administrata Tatimore e Kosovës, Prishtinë.**

**Kundër:**

**E paditura/Ankuesja**

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP),** Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55,  
Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-3902, të datës 10 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 14 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-3902, i datës 10 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 23 dhjetor 2013, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit MIT101-0010, të datës 04 dhjetor 2013, me të cilën ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesën e tatimit në vlerë të shtuar (TVSH) në shumë prej 812.35 euro, si dhe ndaj vendimit MIT101-0011, të datës 04 dhjetor 2013, me të cilën ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesën e borxhit të taksës korporatave, në shumë prej 66.97 euro. Të dy kërkesat Autoriteti i Likuidimit i ka refuzuar si të pa vlefshme me arsyetimin se edhe pas kërkesës për të ofruar dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës e që paditësi e ka pranuar me datë 09 tetor 2013, ai është përgjigjur me 14 tetor 2013, mirëpo dokumentacioni i ofruar nuk ka qenë i detajuar, siç është kërkuar me letrën e dërguar paditësit me datë 27 shtator 2013. Andaj bazuar në nenin 36.2 nën paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesat janë refuzuar si të pa vlefshme. Paditësi në ankesë i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si të pa bazuara, pasi që në përgjigjen e dhënë me datë 14 tetor 2013, është ofruar pasqyra e borxhit tatimor të ndarë në baza tatimore, ndëshkime dhe në interes për subjektin NSH "Jugo Banka", për TVSH-në dhe tatimin në të ardhurat nga korporatat, listën e pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në likuidim të NSH "Jugo Banka" si dhe kërkesat origjinale të datës 11 korrik 2013 për TVSH-në, dhe tatimin në të ardhurat nga korporatat. Përkundër këtyre dëshmime Autoriteti i Likuidimit pa ndonjë bazë ligjore i ka refuzuar të dy kërkesat e paraqitura. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur dy vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit, kërkesën MIT101-0010, të datës 27 shtator 2013, një pasqyrë të borxhit total i ndarë në bazë tatimore, ndëshkime dhe interes, një përgjigje të ATK-së drejtuar për Autoritetin e Likuidimit, formularët e kërkesave, një pasqyrë tjetër të borxhit total të ndarë në bazë tatimore, ndëshkime dhe interes dhe listën e pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në likuidim.

Me datë 15 tetor 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar drejtë. Tutje AKP-ja në mbrojtjen në ankesë pohon se Autoriteti i Likuidimit me datë 27 shtator 2013 i ka dërguar një letër paditësit me të cilën për dy kërkesat ka kërkuar të ofrojë dëshmi relevante në mbështetje të kërkesës. AKP-ja pohon se paditësi e ka pranuar

kërkesën me 9 tetor 2013, ndërsa me 14 tetor 2013 është përgjigjur, mirëpo dokumentacioni i dërguar nuk ka qenë i detajuar. Tutje AKP-ja pohon se bazuar në dokumentet e dërguara nga paditësi, Autoriteti i Likuidimit nuk ka mundur të zbatojë llogaritjen e duhur për TVSH-në e shkaktuar nga NSH-ja apo premiset e saj ndaj paditësit. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se paditësi do të duhej të paraqet prova që brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja të mos i ketë përmbushur obligimet të paraqet kërkesën në gjykatën kompetente. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar.

Me datë 31 tetor 2018, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet e AKP-së të dhëna në mbrojtje në ankesë.

Me datë 06 nëntor 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 10 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-3902, ankesën e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, i ndryshon dy vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit MIT101-0011 dhe MIT101-0010, të datës 04 dhjetor 2013, dhe e obligon AKP-në që ti paguajë paditësit në emër të TVSH-së dhe taksës korporative (tatimi mbi korporatat), shumën prej 113.38 euro, dhe në emër të interesit ligjor prej 10% në shumë prej 11.33 euro, të gjitha në shumë prej 124.71 euro, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar e refuzon si të pa bazuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e obligon AKP-në që të paguajë edhe shpenzimet e procedurës për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 100.00 euro që bashkë me borxhin kryesor do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se duke u bazuar në provat e dorëzuara nga paditësi, përkatësisht ekstraktin e datës 09 korrik 2013, gjykata gjen se shuma e pretenduar në emër të TVSH-së ishte 812.35 euro, nga e cila shumë prej 51.93 euro ishte shuma themelore, kurse shuma e interesit dhe e ndëshkimeve ishte 760.42 euro. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se nga ekstrakti në fjalë shuma e pretenduar nga paditësi në emër të taksës korporative ishte 66.97 euro, nga e cila shumë prej 61.45 euro, ishte shuma themelore, kurse shuma e interesit dhe e ndëshkimeve ishte 5.52 euro. Duke u bazuar në këtë provë, e cila ishte dorëzuar edhe në procedurën e likuidimit, gjykata e ka aprovuar

pjesërisht si të bazuar borxhin në emër të TVSH-së dhe taksës korporative, shumën prej 113.38 euro, duke shtuar edhe shumën prej 11.33 euro si interes ligjor, apo shumën totale të borxhit prej 124.71 euro. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se interesi ligjor është njohur në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pasi që kjo dispozitë ligjore mbizotëron dispozitat e legjislacionit fiskal të parashtruara nga paditësi.

Me datë 07 prill 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-3902 të datës 10 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, dhe të vërtetohen vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. AKP-ja pohon se gjykata e ka vlerësuar në mënyrë të pa drejtë vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke e konsideruar atë si jo ligjorë, për shkak të faktit se Autoriteti i Likuidimit gjatë vendosjes lidhur me kërkesën nuk i ka poseduar të gjitha faktet dhe provat e nevojshme për një vendosje të tillë. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit vendosë në bazë të dokumentacionit që e posedon, dhe në përputhje me ligjin varësisht nga natyra e çështjes, ndërsa paditësi kërkesën e tij për pagesën e TVSH-së dhe taksës korporatave, nuk e ka mbështetur me informata dhe dokumente shtesë, të cilat Autoriteti i Likuidimit i ka konsideruar të nevojshme për vendosje. Prandaj duke mos pasur dëshmi janë marrë vendimet refuzuese për dy kërkesat e ATK-së, pasi që nuk ka pasur mundësi të pranohen kërkesat pa pasur bazë ligjore.

Me datë 13 qershor 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së AKP-së. Në këtë parashtresë ATK-ja pohon se janë të pa qëndrueshme pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë, pasi që ATK-ja konsideron se faktet dhe provat e dorëzuara nga ana e saj janë të mjaftueshme për të përcaktuar gjendjen lidhur me obligimet tatimore. Gjendja (pasqyra) për këtë ndërmarrje nga SIGTAS i ATK-së ku përveç shumës së përgjithshme të borxhit,

definohet shumë qartë se për cilat vite bëhet fjalë, edhe për llojin e tatimeve, ndëshkimet dhe interesi të ndara nga tatimi bazë, andaj çdo gjë ka qenë e pasqyruar në detaje lidhur me borxhet e ndërmarrjes në fjalë. ATK-ja në këtë parashtrësë konsideron se ajo me kohë i ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e nevojshme, dhe brenda afateve të përcaktuara për ti mbështetur të dy kërkesat lidhur me borxhin e pretenduar ndaj NSH-së. Nga këto arsye ATK-ja kërkon nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 11 korrik 2013 i ka paraqitur dy kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit për kompensimin e borgjit në emër të tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), në shumë prej 812.35 euro, dhe kërkesën për pagesën e borxhit në emër të tatimit mbi korporata në shumë prej 66.97 euro. Këto dy kërkesa janë refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit si të pavlefshme, me arsyetimin se edhe pas kërkesës për dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesave, paditësi nuk i ka mbështetur kërkesat e tij me prova duke mos dorëzuar informacionet detaje mbi borxhet e pretenduara ndaj NSH-së "Jugo Banka" në Mitrovicë.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, duke ndryshuar të dy vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit, dhe e ka obliguar AKP-në që në emër të pagesës për TVSH-në dhe në emër të taksës korporative ti paguajë paditësit shumën prej 113.38 euro, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% në shumë prej 11.33 euro ose në shumën e përgjithshme prej 124.71 euro, kurse pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar e ka refuzuar si të pa

bazuar. Shkalla e I-rë këtë vendim e ka bazuar në Ekstraktin e borxhit të NSH-së të datës 09 korrik 2013 të paraqitur nga paditësi, ndërsa interesin ligjor e njeh duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë ka dorëzuar: dy vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kërkesën MIT101-0010, të datës 27 shtator 2013, një pasqyrë të borxhit total i ndarë në bazë tatimore, ndëshkime dhe interes, një përgjigje të ATK-së drejtuar për Autoritetin e Likuidimit, formularët e kërkesave, një pasqyrë tjetër të borxhit total të ndarë në bazë tatimore, ndëshkime dhe interes dhe listën e pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në likuidim.

Bazuar në këto prova, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë pjesërisht e kishte aprovuar ankesën e paditësit, duke ia njohur paditësit të drejtën e kompensimit në emër të TVSH-së, dhe në emër të tatimit në korporatë shumë prej 113.38 euro, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% në shumë prej 11.33 euro. Këto prova në fakt paditësi i kishte dorëzuar edhe tek Autoriteti i Likuidimit të cilat nuk ishin marrë për bazë me arsyetimin e paqëndrueshëm se Autoriteti i Likuidimit nuk kishte informata të detajuara mbi borxhin e pretenduar nga paditësi ndaj NSH-së.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se nuk ka mundësi të ndryshohet rezultati i dhënë me aktgjykimin e ankimuar, andaj ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Ankuesi në bazë të nenit 8.2 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, ATK-ja është e liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_